



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 04.07.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.07.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **“Ilir Kosova” Shpk**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizimi me llaptop, projektor dhe aparate fotokopjuese për Institucionet Arsimore”**, me Nr. të Prok: **616-18-043-12** nxjerr:

V E N D I M

1. *Aprovohet* kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik: **“Ilir Kosova” Shpk** të dt. 02.07.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizimi me llaptop, projektor dhe aparate fotokopjuese për Institucionet Arsimore”** me Nr. **616-18-043-1-2-1** kundër *Njoftimit për anulimin e aktivitetit të Prokurimit të AK*, të datës 26.06.2018.
2. *Anulohet* vendimi i AK për *anulimin e aktivitetit të Prokurimit* me datë: 26.06.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *ta kthej në Rivleresim* aktivitetin e prokurimit për **“Furnizimi me llaptop, projektor dhe aparate fotokopjuese për Institucionet Arsimore”** me Nr. **616-18-043-1-2-1**.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatoreve Ekonomik: **“Ilir Kosova” Shpk**; me datë 02.07.2018, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizimi me llaptop, projektor dhe aparate fotokopjuese për Institucionet Arsimore”**, me Nr. të Prok: **616-18-1759-1-2-1**; me Nr. të brendshëm të prokurimit: **616-18-043-1-2-1**.

Autoriteti Kontraktues me pranimin e kërkesës për rishqyrtim, me datë 04.07.2018 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të lëndës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimit, duke u bazuar në deshmitë e ofruara me specifikimin teknik (**How to Optimize Image Size and Distance**) Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim është e bazuar dhe se Njoftimi për anulim i aktivitetit të

prokurimit per: Furnizimin me rekuizita sportive te anulohet dhe se lenda te kthehet ne rivleresim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

NEXHMI MEKOLLI



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

